# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447093**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “O Taulant, o hajdut”, qytetarët detyrojnë Ballën të ngrihet nga tavolina |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391891.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 18:50:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 18:44:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 18:43:00 UTC → 15 shtator 2026, 18:45:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6d6d9c5a1149635cc0825cd4e8d41a2c890728b76b4d31b7fc21848b8d220e05` |
| TEKSTI | `ff92b3a6eb7784a186bb8b52f22257448c39fcb82cec3c2774779c38d455c6e7` |
| PAMJA | `8f085388cfe7161a35ccacfe76155e4282f0a01fa868b184d357d4ccb2b83842` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8bf4b3c3a0466db12f490946f5acc1fbfeb96f14a0ee434a7ef78de4518c84b6` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8bf4b3c3a0466db12f490946f5acc1fbfeb96f14a0ee434a7ef78de4518c84b6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “O Taulant, o hajdut”, qytetarët detyrojnë Ballën të ngrihet nga tavolina

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 15.09.2026, 20:44

Share Share



Pas Belinda Ballukut, protestuesit kanë pikasur një tjetër prej figurave kryesore të mazhorancës, këtë herë Taulant Ballën.

Gjatë ditës së 108-të të protestës kundër qeverisë dhe klasës politike, Balla është pikasur nga qytetarët teksa qëndronte i ulur në një nga ambientet e jashtme të një lokali pranë stadiumit “Arena Kombëtare” në Tiranë.

Në momentin që e kanë dalluar, protestuesit i janë drejtuar në kor me thirrje si: “O hajdut!”, “O kriminel!” dhe “O Taulant, o hajdut!”.

Në pamjet e dërguara në redaksinë e JOQ Albania, dëgjohen thirrjet e qytetarëve, ndërsa Balla ngrihet nga tavolina dhe largohet nga ambienti i jashtëm i lokalit.

Taulant Balla është një prej figurave më të rëndësishme të Partisë Socialiste. Aktualisht ai drejton Grupin Parlamentar të PS-së në Kuvend, ndërsa më herët ka mbajtur poste të rëndësishme qeveritare, përfshirë atë të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Përplasja verbale me qytetarët vjen vetëm dy ditë pas një episodi të ngjashëm me Belinda Ballukun, e cila gjatë ditës së 106-të të protestës u pikas nga protestuesit teksa po i drejtohej automjetit të saj. Edhe atëherë, qytetarët e shoqëruan me thirrje në kor: “O hajdute!”, “Rama në burg, Belinda në burg!”.

Kësaj radhe, në shënjestër të thirrjeve të protestuesve ishte Taulant Balla, i cili pas përballjes me qytetarët zgjodhi të largohej nga ambienti ku ishte ulur.

Protesta vijon prej 108 ditësh, me qytetarët që kërkojnë llogaridhënie dhe përsërisin thirrjet kundër qeverisë dhe figurave të saj.



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?


View this post on Instagram

A post shared by JOQ Albania (@joqalbania)

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

**Më të fundit**

Dërgo materialin tënd këtu ›

Puno me ne! | Marketing | Politika e privatësisë | Rreth Nesh | Kushtet e përdorimit | Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.